



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 26.

Prishtinë, më 13 korrik 2009, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Adem Hajdaraj, Armend Zemaj Ibrahim Makolli, dhe Kolë Berisha.

Munguan: Selvije Halimi, Branislav Gerbiq dhe Džezair Murati.

Të pranishëm: Arben Krasniqi – Zyra e Kryeministrit, Bedri Bahtiri – Ministria e Drejtësisë, Mentor Borovci dhe Jetullah Aliu – Agjencia Kundërkorrupsionit, David Wolstenholne – EU-AC, Lendita Kastrati – Projekt Komisioni Evropa, Georgi Rupcher – EU-AC, Eduard Pesendorfer – OSBE, Ekrem Beqiri – ZKM, Petrit Zogaj – Fol `08, Rrezarta Ahmeti – KDI, Ramadan Islami – OSBE dhe Visar Krasniqi – Kuvendi i Kosovës.

Nga stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

R e n d i i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 6 korrikut 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë;

4. Shqyrtimi i Projektstrategjisë së Qeverisë të Republikës së Kosovës kundër korrupsionit 2009 – 2011;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari - I përshëndeti të pranishmit, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, të Agjencisë Kundërkorrupsionit, të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, të Zyrës së EULEX-it, Shoqërinë Civile dhe ata që e përcollën punën e Komisionit.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 6 korrikut 2009

Kryetari – I pyeti anëtarët e Komisionit a kanë vërejtje rreth procesverbalit.

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë

Kryetari - Lidhur me Projektligjin për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë njoftoi se i është rekomanduar Kuvendit, por nuk është nënshkruar nga përfaqësuesi ndërkombëtar, që ka pasur autoritet. Po ashtu i njoftoi për komentet e Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian, që i cilësoi të qarta dhe të drejta. Për këtë pikë hapi debat duke filluar nga titulli i ligjit se a do të duhej të quhej ligj për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë apo ligj për deklarimin dhe prejardhjen e pasurisë. Ftoi përfaqësuesin e Ministrisë së Drejtësisë ta jepte mendimin rreth titullit të këtij projektligji.

Bedri Bahtiri – Për futjen e nocionit “kontrollin”, shtoi se kapitulli IV parasheh kontrollin e pasurisë, prandaj përveç deklarimit e kemi futur edhe kontrollin e pasurisë, duke u bazuar se një zgjidhje të tillë e ka edhe Shqipëria.

Georgi Rupcher – Duke iu referuar komenteve të kësaj zyre shtoi se titulli i këtij projektligji në versionin në gjuhën angleze është: “Ligji për deklarimin dhe origjinën e pasurisë”. Shtoi se në komentet tona jemi marrë kryesisht me çështjen e prejardhjes. Për ne nuk është shumë e qartë se si ky ligj do të merret me prejardhjen e pasurisë, meqenëse brenda institucioneve të Kosovës ekzistojnë organet të cilat merren me këtë çështje.

Adem Salihaj – Rikujtoi se edhe kur është shqyrtuar Projektligji në Komision, kishte paraqitur pikëpamjet se përmbajtja e tij nuk ishte në përputhje me titullin. Shtoi se Projektligji në titull parasheh deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin, por nuk ka kapitull për prejardhjen e pasurisë. Theksoi se është e nevojshme ndihma e Zyrës Ndërlidhëse e

Komisionit Evropian dhe e atyre që mund të ofrojnë komente për ta bërë një ligj sa më funksional.

Bajram Kosumi – Për titullin e ligjit, shtoi se nocioni “kontrolli i pasurisë”, duhet të mbetet në titull, mirëpo problem është prejardhja e pasurisë, sepse kështu, siç parashihet në Projektligj, Agjencia merr kompetencën për ta hulumtuar prejardhjen e pasurisë, prandaj këtë funksion nuk mund ta kryejë Agjencia, ngase atë e ushtrojnë gjykatat dhe administrata tatimore. Propozoi që në titull nocioni “Prejardhjen” të hiqet dhe të mbetet “Ligji për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë të zyrtareve të lartë publikë”. Propozoi të shtohet një paragraf i ri dhe neni 13 të behet 13.4, me të cilin do t’i jepnim Agjencisë kompetencë të kërkojë njoftime për prejardhjen e pasurisë në raste dyshimi.

Armend Zemaj – Për titullin e ligjit tha se është i qëlluar dhe duhet ta fuqizojmë. Theksoi se thelbi i tij është deklarimi i pasurisë. Kur flitet për deklarimin duhet të dihet se prej nga vjen ajo pasuri. Iu referua nenit 7. Duhet të qartësohet, posaçërisht të caktohen afate nëse në ligj kërkohet të dihet prejardhja e pasurisë, cilat janë masat ndëshkuese, si dhe detyrimet e paraqitjes së të dhënave dhe kompetencat e Agjencisë sipas nenit 13.

Bedri Bahtiri – Mbrojtji qëndrimin se duhet të mbetet ky titull i ligjit. Theksoi se vetëm deklarimi i pasurisë, pa mekanizmin, me të cilin do të kërkohej prejardhja e saj do të ishte i mangët.

Armend Zemaj – Vuri në pah se do të duhej t’i jepej kompetencë Agjencisë ta hulumtojë prejardhjen e pasurisë, veçanërisht t’i verifikojë deklarimet e zyrtarëve të lartë, ngase deklarimi mund të mos korrespondojë me pasurinë reale.

Adem Hajdaraj - Theksoi se titulli i ligjit nuk mund ta përfshijë gjithë përmbajtjen e atij lëmi. Mjafton që Projektligj ta këtë titullin “Projektligji për deklarimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë”, ndërsa në dispozita të tjera të këtij ligji janë kontrolli dhe prejardhja, që nuk do të thotë se patjetër duhet të jenë në titull.

Ibrahim Makolli – Shtoi se titulli i këtij projektligji nuk është në harmoni me brendinë e tij, sepse janë vetëm dy nene në të cilat flitet për burimet e pasurisë. Duke shprehur dyshimin se ky ligj, kështu si është, nuk ofron garanci, që kjo agjenci ta kryejë punën ashtu si duhet, sepse për të do të duhej një mekanizëm i tërë i shtetit. Në vazhdim tha se vendi ka nevojë për një ligj për prejardhjen e pasurisë, jo vetëm të zyrtareve të lartë.

Kryetari – Propozoi që titulli të mbetet ashtu si është në projektligj, vetëm se duhet të harmonizohen versioni në gjuhën angleze dhe në gjuhën serbe. Lidhur me nenin 1 të qëllimi i ligjit, u propozua të shtohet: “dhe zyrtarët e tjerë të paraparë në këtë ligj”, ndërsa formulimi do të ishte: “Ky ligj i përcakton detyrimet e zyrtarëve të lartë publikë dhe të zyrtarëve të tjerë të paraparë në këtë ligj”.

Pas një debati që u zhvillua Komisioni vendosi që më 20. 7. 2009, në orën 10, të organizojë dëgjim publik, në të cilin do të ftohen përfaqësuesit e Agjencisë së Kundërkorrupcionit, përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë, të Zyrës Ndërlidhëse të

Komisionit Evropian, të Zyrës së Eulex-it, përfaqësues nga niveli politik, prokurorë, gjyqtarë, profesorë, përfaqësues të policisë për krime ekonomike, Shoqërinë Civile, që të merren opinionet e tyre.

4. Shqyrtimi i Projektstrategjisë së Qeverisë të Republikës së Kosovës kundër korrupsionit 2009 – 2011

Lidhur me këtë pikë nuk pati debat. Mbetet të debatohet në një nga mbledhjet e radhës.

5. Të ndryshme.

a. Komisioni e shqyrtoi bazën juridike të projektligjeve për tatimin në të ardhurat e korporatave, Projektligjin për miniera dhe minerale, Projektligjin për ndryshimin, plotësimin e Ligjit nr. 02/L-36 për duhanin dhe Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për prokurimin publik në Kosovë. Vlerësoi se projektligjet kanë bazë juridike në pajtim me nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

b. Komisioni vendosi të mbajë mbledhje më 15. 7. 2009 lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për hetimin parlamentar.

E hartoi:

Stafi Mbështetës i Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni